

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-141/2013

Prishtinë, 20 Korrik 2015

Në çështjen juridike të:

**V K
S B 19
P**

Pala ankuese/Paraqitësi i kërkesës

Kundër

**M G
D F
Sh S**

R A 38
20... P

Komuna e P

P

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/192/2013 (lëndët e regjistruar në AKP me numrat KPA11526 dhe KPA11587), të datës 13 shkurt 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 20 Korrik 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Bashkohen ankesat e paraqitura nga V K të datës 5 korrik 2013, të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-141/2013 dhe GSK-KPA-A-142/2013 në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-141/2013.
2. Refuzohen si të pabazuara ankesat e V K kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/192/2013 të datës 12 shkurt 2013 për sa i takon kërkesave të regjistruar në AKP me numrat KPA11526 dhe KPA11587.
3. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/192/2013 (për sa i takon kërkesave të regjistruar në AKP me numrat KPA11526 dhe KPA11587) i datës 12 shkurt 2013.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 23 May 2006, paraqitësi i kërkesës V K ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar në mënyrë specifike konfirmimin e së drejtës pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës 2360 me sipërfaqe prej 3ha e 62 ari(KPA11526), që ndodhet në Prizren si dhe konfirmimin e së drejtës pronësore dhe legalizimin e një dyqani komercial me sipërfaqe prej 37.22m² që ndodhet në të njëjtën ngastër nr.2360(KPA11587). Ai deklaron se prona e tij i kishte përkitur babait të tij deri në vitin 1959, por ajo ishte marrë në mënyrë të paligjshme nga Komuna e Prizrenit, duke cekur 1 majin 1959 si datë të humbjes.
2. Për të mbështetur kërkesat e tij, ai ka dorëzuar në AKP dokumentet në vijim:
 - Padinë e datës 27 qershor 2001 të parashtruan në Gjykatën Komunale të Prizrenit;
 - Fletën poseduese nr.8414, të datës 11 gusht 2006 të lëshuar nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, e cila tregon se Kuvendi Komunal i Prizrenit është pronar i pronës së kërkuar;
 - Si dhe disa dokumente tjera që duket se nuk janë relevante për rastin.
3. Kërkesat ishin regjistruar në AKP me numrat KPA11526 dhe KPA11587.
4. Sipas Raporti të Konsoliduar të Verifikimit të AKP-së të datës 23 nëntor 2012, përveç padisë të gjitha dokumentet tjera të lartpërmendura ishin verifikuar negativisht nga Sekretaria Ekzekutive.

5. Më 13 maj 2009, ekipi për njoftim i AKP-së, në bazë të hartës kadastrle dhe adresës ka bërë njoftimin e pronës duke vendosur një shenjë në vendin ku ndodhej prona e kërkuar. Prona është gjetur të jetë komerciale me objekte që përbëheshin nga 4 banesa dhe 2 dyqane. Prona ishte shfrytëzuar nga M G , Sh Spahiu dhe D F , të cilat kanë pretenduar të drejtën ligjor mbi pronën dhe e kanë nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes më 13 maj 2009. Njoftimi pronës sipas kërkesës KPA11587 ishte bërë më 11 janar 2008 dhe është gjetur të jetë një dyqan i shfrytëzuar nga vetë paraqitësi i kërkesës.
6. Shfrytëzuesit e kanë kundërshtuar kërkesën dhe kanë pohuar se ishin në shfrytëzim të pronës me qëllim të banimit. Ata janë paraqitur në AKP në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë, duke dorëzuar disa dokumente në mbështetje të pretendimeve të tyre, të cilat janë verifikuar nga AKP-ja.
7. Pas njoftimit të pronës, zyrtari komunal B M është paraqitur në AKP si palë përgjegjëse në kërkesë, ku ka deklaruar se prona e kërkuar i përket Komunës së Prizrenit. Për të mbështetur deklaratën e tij, ai ka dorëzuar dokumentet në vijim:
 - Certifikatën për pronën e paluajtshme nr.18-848, të datës 23 gusht 2012, të lëshuar nga Zyra Komunale për Kadastër e Prizrenit;
 - Një dokument zyrtar të datës 30 gusht 2012, i cili dëshmon se M G , S S (nëna e palës përgjegjëse në kërkesë Sh S), D F dhe disa të tjerët janë pronarë ligjor të pronës së kërkuar.
8. Pas verifikimit nga ekipi për verifikim i AKP-së është gjetur se prona e kërkuar, ngastra nr. 2360 është e regjistruar në emër të Kuvendit Komunal të Prizrenit.
9. Me vendimin KPCC/D/C/192/2013, të datës 13 shkurt 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) kishte vendosur që të hedhë poshtë kërkesat me arsyetimin se paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë se kërkesat e tij janë të ndërlidhura me konfliktin e armatosur të vitit 1998-1999, pra kërkesat janë jashtë juridiksionit të KKPK-se.
10. Vendimi i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 7 qershor 2013.

11. Më 5 korrik 2013, paraqitësi i kërkesës (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së.

Pretendimet e palës ankuese:

12. Pala ankuese në ankesën e ti thirret në shkeljet esenciale të së drejtës materiale, të drejtës procedurale dhe vërtetimit të gabuar të fakteve. Ai kundërshton vendimin e KKPK-së duke thënë se është i bazuar në një copë letre e cila e ka privuar pronarin e pronës nga të drejtat e tij ligjore. Ai gjithashtu pretendon se nuk kishte pasur mundësi të përshkruaj historikun e pronës në fjalë dhe përveç kësaj ai ka thënë se e kishte pandërprerë shfrytëzuar pronën, dyqanin për 12-13 vite, derisa ka ndërhyrë AKP-ja.

Prandaj, pala ankuese kërkon që të pranohen kërkesat e tij dhe të merret një vendim racional.

Arsyetim ligjor:

Bashkimi i ankesave:

13. Gjykata i referohet nenit 408.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme LPK), që zbatohet *mutatis mutandis* (sipas nevojës) në procedurën para Gjykatës Supreme (neni 12.2 i Ligjit 03/L-079). Ky ligj parasheh se gjykata mund t'i bashkojë procedurat nëse një bashkim i tillë kontribuon në ekonomizimin e këtyre procedurave.
14. Në tekstin e ankesë të paraqitur nga pala ankuese, Gjykata Supreme gjen se e gjithë baza faktike dhe ligjore, si dhe çështjet e administrimit të provave janë krejtësisht të njëjta në këto dy raste. Vetëm klasifikimi i pronave është i ndryshëm.
15. Lëndët e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-141/2013 dhe GSK-KPA-A-142/2013 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-141/2013.

Pranueshmëria e ankesës

16. Ankesa është e pranueshme. Ajo është parashtruar brenda afatit prej 30 ditëve të paraparë me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Juridiksioni

17. Gjykata Supreme ka juridiksion për të shqyrtuar ankesën.
18. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK ka juridiksion që të zgjidhë kërkesat që ndërlidhen me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999, kërkesat që ndërlidhen me të drejtat të cilat nuk mund të ushtrohet si pasojë e rrethanave që ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur.
19. Faktet e vërtetuara shpijnë në konkludim se kontesti në lidhje me pronën në fjalë nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur të viteve 1998/99. Ai daton qysh nga viti 1959, kur prona e familjes së tij ishte konfiskuar dhe marrë nga Komuna e Prizrenit. Ky fakt konfirmohet nga pala ankuese në kërkesat dhe në ankesat e tij. Familja e palës ankuese e kishte humbur posedimin shumë kohë para konfliktit të armatosur.
20. Pas verifikimit nga Sekretaria Ekzekutive të Certifikatës së të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme nr.P-71813068-02360-0, të datës 8 nëntor 2009 të lëshuar nga Zyra Komunale për Kadastër në Prizren, rezulton se prona e kërkuar është pronë shoqërore, e regjistruar si PSH. KK.Prizren (pronë shoqërore e Kuvendit Komunal të Prizrenit). Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë që të zgjidh pronësinë mbi kërkesat për *pronën private* dhe kërkesat lidhur me të drejtat e shfrytëzimit të pronës që kanë bërë me *pronën e paluajtshme private*. Pasi që prona në kontest nuk ishte pronë private por pronë shoqërore, lënda nuk bie në juridiksion të KKPK-së. Si rezultat, Gjykata Supreme gjeti se vendimi i KKPK-së ishte i drejtë dhe i mbështetur mbi bazën faktike dhe procedurale. Prandaj, vendimi i kundërshtuar ishte i drejtë dhe duhet të konfirmohet.
21. Në bazë të arsytimit dhe sipas dispozitës së nenit 13.3 nën (c) të Ligjit nr. 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike..

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it